

 www.guideks.org  
 contact@guideks.org, guidesinkosovo@gmail.com  
 +383(0)49372639, +383(0)44128830  
 GuideKs  
 guidesinkosovo

Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

# RREGULLORJA 1/2022

## PËR ZGJEDHJE, MANDAT DHE KOMPETENCAT E:

## KRYESUESIT TË KUVENDIT, BORDIT DHE DREJTORIT EKZEKUTIV

### 1. MANDATI DHE ZGJEDHJA E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË ANËTARËVE

1.1. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës. Kuvendi i Anëtarëve ka kompetencë të zgjedhë dhe të shkarkojë anëtarët e Bordit Ekzekutiv, të aprovojë raportet vjetore financiare dhe të punës, të interpretojë dhe ndryshojë Statutin, si dhe të vendosë për bashkimin, ndarjen apo shuarjen e shoqatës. Këto përgjegjësi nuk mund të delegohen në organet tjera më të ulëta.

1.2. Përpos përgjegjësi të rezervuara që ka, Kuvendi i Anëtarëve të Shoqatës gjithashtu ka edhe këto përgjegjësi:

1.2.1. Të zgjedhë nga radhët e veta njërin prej anëtarëve që të kryej punët e Kryesuesit të Kuvendit të Anëtarëve;

1.2.2. Të zgjedhë dhe shkarkojë Drejtorin Ekzekutiv të organizatës;

1.2.3. Të aprovojë Planet e punës, Raportet e punës dhe Raportet vjetore financiare,

1.2.4. Të aprovojë akte të tjera që konsiderohen të nevojshme për funksionimin e organizatës,

1.2.5. Të kontrollojë mbarëvajtjen e punës dhe atë financiare sa herë që e sheh të nevojshme

1.3. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësi të tij në organin tjetër udhëheqës të ndërmjetëm (Bordi Ekzekutiv) ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij, me përjashtim të përgjegjësi të cilat nuk delegohen sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe paragrafit 2 të Neni 5 të këtij Statuti.

### **Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve dhe përzgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Anëtarëve**

1.4. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, deyrimet, të



 [www.guideks.org](http://www.guideks.org)  
 [contact@guideks.org](mailto:contact@guideks.org), [guidesinkosovo@gmail.com](mailto:guidesinkosovo@gmail.com)  
 +383(0)49372639, +383(0)44128830  
 GuideKs  
 guidesinkosovo

Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.

1.5. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve ose nga organet tjera. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit të Anëtarëve i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat e përcaktuara në paragrafin vijues.

1.6. Lajmërimi me shkrim për MPV dhe/ose MPJ, duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për mbledhjen do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku dhjetë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

1.7. Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve, Bordi Ekzekutiv dhe Drejtori Ekzekutiv i GUIDEKS kanë mandat 4 vjeçar dhe këto pozita zgjedhën në të njëjtin takim të Kuvendit të Anëtarëve.

1.8. Për pozitën e Kryesuesit të Kuvendit mund të aplikojë cilido anëtar i cilëso kategori të organizatës dhe atë vetëm nëse është prezent fizikisht (përfshi edhe virtualisht) gjatë takimit të MPV apo MPJ.

1.9. Anëtari i organizatës, i cili/e cila përzgjidhet në pozitën e Kryesuesit, nëse paraprakisht ka qenë anëtar i kategorisë si anëtar i asociuar apo anëtar i rregullt obligohet që në afat prej 14 ditë të kryejë obligimet e anëtarit të plotë të përcaktuar me Rregullore të veçantë për anëtarësim.


1.10. Zgjedhjet për Kryesues të Kuvendit mund të zhvillohen me një apo disa kandidatë. Për çdo kandidat organizohet votim i veçantë dhe atë me vota PËR, KUNDËR apo ABSTENIM. Anëtari me më së shumti vota PËR përzgjedhet Kryesues i Kuvendit. Në rast të numrit të njëjtë të votave PËR, atëherë anëtari me më së shumti vota PËR dhe ABSTENIM përzgjedhet Kryesues i Kuvendit.

1.11. Zgjedhjet për Kryesues të Kuvendit të Anëtarëve mund të zhvillohen edhe me një kandidat. Në rastet e tilla kur kemi vetëm një kandidat dhe kandidati nuk merr shumicën e votave (50%) atëherë në votimin e dytë që duhet të organizohet mund të pranohet edhe 1/3 e votave të kuorumit të takimit.

1.12. Në rast të mosplotësimit të kushteve nga neni 1.10 apo edhe për çfarëdo arsye tjetër nuk zgjidhet kryesuesi në takim, Kryesuesi ekzistues i Kuvendit të Anëtarëve obligohet të vazhdon mandatin deri në organizimin e zgjedhjeve të ardhshme të cilat duhet të ndodhin më së largu pas 30 ditëve.

1.13. Në rast të situatave të jashtëzakonshme ku kryesuesi nuk mundet të zhvillojë procedurat e organizimit të takimit të Kuvendit, atëherë kjo e drejtë i kalon përkohësisht Drejtorit Ekzekutiv në fuqi.

1.14. Mandati kryesor i Kryesuesit të Kuvendit është ftesa, organizimi dhe mbarëvajtja e takimeve të Kuvendit si dhe hartimi i procesverbaleve nga këto takime.



 [www.guideks.org](http://www.guideks.org)  
 [contact@guideks.org](mailto:contact@guideks.org), [guidesinkosovo@gmail.com](mailto:guidesinkosovo@gmail.com)  
 +383(0)49372639, +383(0)44128830  
 GuideKs  
 guidesinkosovo

Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

---

1.15. Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve obligohet të mirëmbajë evidencën e anëtarësisë së organizatës dhe të sigurojë këtë listë që ajo të jetë publike dhe e qasshme për të gjithë anëtarët.

1.16. Kryesuesi i Kuvendit menaxhon procesin e aplikimit, votimit dhe pranimit të anëtarëve të rinj në organizatë.

1.17. Kandidati për Kryesues të Kuvendit nuk ka të drejtë të kandidojë për paralelisht edhe për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv.

1.18. Kandidati për Kryesues të Kuvendit ka të drejtë të kandidojë dhe të përzgjedhet për anëtar të Bordit Ekzekutiv.

1.19. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të Kryesuesit të Kuvendit apo edhe dorëheqjes, Kuvendi i Shoqatës duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur të mandatit 4 vjeçar.



www.guideks.org

contact@guideks.org, guidesinkosovo@gmail.com

+383(0)49372639, +383(0)44128830

GuideKs

guidesinkosovo

Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

## 2. MANDATI DHE ZGJEDHJA E BORDIT EKZEKUTIV

Qëllimi kryesor i punës së Bordit Ekzekutiv është të ofrojë udhëheqje dhe drejtim për organizatën. Bordi Ekzekutiv do të punojë ngushtë me Drejtorin Ekzekutiv për të zhvilluar strategji për rritjen e mbledhjes së fondeve, avokimin, promovimin, zhvillimin, mbarëvajtjen dhe monitorimin e organizatës. Bordi Ekzekutiv është përgjegjës për të siguruar zbatimin efektiv të strategjisë së organizatës. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv janë përgjegjës për planifikimin strategjik në mënyrë që të sigurohet përmbushja efektive dhe me sukses e misionit të organizatës. Anëtarët e bordit janë përgjegjës për ruajtjen e imazhit të GUIDEKS duke qenë aktivë dhe të dukshëm në komunitet dhe duke punuar ngushtë me organizata të tjera profesionale, qytetare dhe ato private.

Duke e marrë parasysh funksionin e Bordit Ekzekutiv si organ udhëheqës i ndërmjetëm, ai konsiderohet edhe si organ përkrahës dhe njëkohësisht monitorues i punës së Drejtorit Ekzekutiv.

### Organi udhëheqës i ndërmjetëm (Bordi Ekzekutiv)

2.1. Bazuar në përgjegjësitë e dhëna me këtë statut, organi udhëheqës i ndërmjetëm, Bordi Ekzekutiv, duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.

2.2. Bordi Ekzekutiv ka mandat 4 vjeçar.

2.3. Bordi Ekzekutiv ka këto përgjegjësi:

- të propozoj përfaqësuesin e autorizuar të organizatës,
- të kontrollojë implementimin e qëllimit dhe aktivitetëve të parapara në statut,
- mbikëqyrjen e punës së zyrtarëve dhe nëpunësve të OJQ-së.

2.4. Bordi zgjedhet nga Kuvendi i Shoqatës. Ata do të zgjedhen individualisht (të propozuar nga vet personi që dëshiron të kandidojë apo edhe të propozuar nga anëtarët tjerë) me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm.

2.5. Vetëm anëtarët e kategorisë së plotë të organizatës mund të kandidohen për anëtar të Bordit Ekzekutiv.

2.6. Bordi do të ketë të paktën 3 (tre) dhe më së shumti 5 (pesë) anëtarë, njëri nga të cilët duhet të zgjedhet si Kryesues i Bordit. Përzgjedhja e Kryesuesit bëhet në takim apo votim të veçantë mes vet anëtarëve të Bordit Ekzekutiv.

2.7. Zgjedhjet për anëtarë të Bordit Ekzekutiv mund të zhvillohen me disa kandidatë. Për çdo kandidat organizohet votim i veçantë dhe atë me vota PËR, KUNDËR apo ABSTENIM. Anëtarët me më së shumti vota PËR përzgjedhen anëtarë të Bordit Ekzekutiv. Në rast të kandidatëve me numër të njëjtë të votave PËR, atëherë anëtari me më së shumti vota PËR dhe ABSTENIM përzgjedhet Drejtor Ekzekutiv.

2.8. Drejtori Ekzekutiv bëhet automatikisht pjesë përbërëse e Bordit Ekzekutiv ku bashkë me anëtarë tjerë mund të ketë përbërje deri në gjithsej 6 anëtarë.

2.9. Anëtarët e Bordit mund të zgjedhen për mandate të njëpasnjëshme.



www.guideks.org

contact@guideks.org, guidesinkosovo@gmail.com

+383(0)49372639, +383(0)44128830

GuideKs

guidesinkosovo

Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

---

2.10. Anëtarët e Bordit mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me shumicë votash të Kuvendit të Shoqatës.

2.11. Mandati i anëtarit të Bordit pushon:

- Në rast të vdekjes,
- Dorëheqjes ose
- Shkarkimit nga Kuvendi i Anëtarëve.

2.12. Inicimi i shkarkimit të një anëtarit të Bordit Ekzekutiv bëhet me propozim të shkruar të shumicës së anëtarëve të Bordit Ekzekutiv. Propozimi duhet të përfshijë edhe shkeljet apo arsyet e propozimit për shkarkim. Vendimi përfundimtar merret në Kuvend të Anëtarëve.

2.13. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Bordit, Kuvendi i Shoqatës duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur të mandatit 4 vjeçar.

### **Takimet e Bordit Ekzekutiv**

2.14. Bordi Ekzekutiv obligohet për takime të përbashkëta së paku një herë në muaj (fizikisht apo virtualisht) në mënyrë që të monitorojnë, planifikojnë dhe zhvillojnë aktivitetet e organizatës.

2.15. Takimet e Bordit ftohen nga Kryesuesi i Bordit Ekzekutiv dhe duhet të paralajmërohen një javë përpara datës së takimit apo të përcaktohen me kalendar fiks vjetor (psh dita e caktuar e çdo muaji).

2.16. Takimet e Bordit Ekzekutiv, mund të thirren edhe jashtë takimeve të rregullta të planifikuara.

2.17. Në rast të mungesës së arsyeshme të Kryesuesit të Bordit, takimi mund të ftohet dhe udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv.

2.18. Takimet dhe vendimet e Bordit Ekzekutiv janë valide vetëm në rast të sigurimit të kuorumit të nevojshëm, pra 50% të anëtarëve duhet të jenë prezent.

2.19. Votimi në takimet e Bordit Ekzekutiv bëhet me shumicë të thjeshtë. Vetëm në rast të numrit çift të prezencës së anëtarëve të Bordit (4 apo 6) Drejtori Ekzekutiv ka të drejtën e votës së dyfishtë. Vota e dyfishtë nuk mund të përdoret për rastet tjera.

2.20. Kryesuesi i Bordit Ekzekutiv, ose një nga anëtarët e Bordit, mbajnë procesverbalin e takimit bashkë me të gjitha vendimet e tij, i cili i shpërndalet anëtarëve të Bordit në takimin vijues ku edhe duhet të aprovohet.

2.21. Bordi mund të vendosë t'i drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimit, sikurse votimi virtual i dokumenteve të prodhuara, diskutimi për çështje të caktuara, etj.



 [www.guideks.org](http://www.guideks.org)  
 [contact@guideks.org](mailto:contact@guideks.org), [guidesinkosovo@gmail.com](mailto:guidesinkosovo@gmail.com)  
 +383(0)49372639, +383(0)44128830  
 GuideKs  
 guidesinkosovo

Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

---

## **Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar**

2.22. Bordi Ekzekutiv, Drejtori Ekzekutiv dhe Zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.

### **Kompensimi financiar**

2.23. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona bëjnë për këtë organizatë.

2.24. Çdo transaksion ndërmjet OJQ-së dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, zyrtarëve, ndalohet, përveç, nëse Bordi Ekzekutiv vendos, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për OJQ-në, dhe se OJQ-ja nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.

2.25. Kurrfarë pagese ose kompensimi nuk duhet t'u bëhet anëtarëve të Bordit pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa ose kompensime është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për organizatë.

2.26. Asnjë anëtar i Bordit nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i Bordit konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.



www.guideks.org

contact@guideks.org, guidesinkosovo@gmail.com

+383(0)49372639, +383(0)44128830

GuideKs

guidesinkosovo

Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

### 3. MANDATI DHE ZGJEDHJA E DREJTORIT EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv është pozita me përgjegjësi të lartë ekzekutive në organizatë që siguron mbarëvajtjen e punëve administrative, financiare dhe aktivitetet që zbaton organizata. Drejtori është përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera normative në veprimtarinë e shoqatës përfshi edhe Statutin dhe Rregulloret tjera të brendshme.

3.1. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet për mandat 4 vjeçar me të drejtë të rizgjedhjes.

3.2. Secili anëtar ka të drejtë të kandidojë për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv nëse ai/ajo është anëtar i kategorisë së plotë të organizatës si dhe ka së paku (2) dy-vite përvojë si anëtar i organizatës.

3.3. Në rast të dështimit të përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv nga radhët e anëtarësisë, Bordi Ekzekutiv, si organ i ndërmjetëm i organizatës mund të propozojë një apo më shumë kandidatë me të cilët paraprakisht komunikon dhe diskuton për mundësinë e angazhimit të tyre për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv. Kandidatët potencial duhet të dërgojnë të gjitha dokumentet e kërkuara të përcaktuar anë nenin 3.6.

3.4. Në rast të dështimit të propozimit të përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv nga Bordi Ekzekutiv, Kuvendi i Anëtarëve mund të shpall konkurs për pozitën për kandidat potencial jashtë organizatës. Për këtë çështje Bordi Ekzekutiv organizon vetë ose propozon edhe përbërjen e Komisionit të veçantë që do të merret me procesin e aplikimit, intervistimit dhe rekrutimit të kandidatëve.

3.5. Zgjedhjet për Drejtor Ekzekutiv organizohen nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve i/e cili/a i njofton të gjithë anëtarët e organizatës për datën e zgjedhjeve për Drejtor Ekzekutiv dhe fton të interesuarit të kandidojnë. Kryesuesi/ja cakton një periudhë deri kur do të pranohen kërkesat për kandidim për Drejtor Ekzekutiv. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e shkurtër se (10) dhjetë ditë nga data e shpalljes së njoftimit.

3.6. Kandidatët për Drejtor Ekzekutiv dërgojnë aplikimin tek Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve për të garuar për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv. Aplikimi duhet të përmbajë këto informacione: Emri dhe mbiemri, numri personal, datën dhe vendin e lindjes, periudha e angazhimit në GUIDEKS (nëse aplikohet), një biografi të shkurtër apo CV si dhe një letër motivuese për kandidaturën e saj/ të tij për pozitën.

3.7. Nëse kandidati përzgjedhet në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv, atëherë obligohet që të sigurojë edhe dëshminë që nuk është u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj tij/saj nga institucioni përkatës. Ky dokument duhet të dorëzohet në afat më së largu për 14 ditë tek Kryesuesi i Kuvendit.

3.8. Pasi përfundon afati për paraqitjen e kërkesave për të kandiduar për postin e Drejtorit Ekzekutiv, Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve verifikon kërkesat nëse janë plotësuar kushtet përkatëse. Pas përfundimit të verifikimit Kryesuesi/ja në takim të Kuvendit (MPV/MPJ) njofton të gjithë anëtarët e organizatës me kandidatët për postin e Drejtorit Ekzekutiv.





Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

3.9. Votimi për përzgjedhje të kandidatëve për Drejtor Ekzekutiv bëhet me shumicë të thjeshtë të votave prezent të anëtarëve të kategorisë së plotë dhe ata të asociuar në takimin e Kuvendit (MPV/MPJ).

3.10. Zgjedhjet për Drejtorin Ekzekutiv mund të zhvillohen me disa kandidatë. Për çdo kandidat organizohet votim i veçantë dhe atë me vota PËR, KUNDËR apo ABSTENIM. Anëtari me më së shumti vota PËR përzgjedhet Drejtor Ekzekutiv. Në rast të numrit të njëjtë të votave PËR, atëherë anëtari me më së shumti vota PËR dhe ABSTENIM përzgjedhet Drejtor Ekzekutiv.

3.11. Zgjedhjet për Drejtorin Ekzekutiv mund të zhvillohen edhe me një kandidat. Në rastet e tilla kur kemi vetëm një kandidat dhe kandidati nuk merr shumicën e votave për zgjedhje atëherë Drejtori Ekzekutiv ekzistues vazhdon mandatin deri në organizimin e zgjedhjeve të ardhshme të cilat duhet të ndodhin më së largu pas 30 ditëve.

3.12. Drejtori Ekzekutiv nuk mund të jetë personi që kërkohet nga organet e rendit ose ka kryer ndonjë vepër penale për të cilën është shpallur fajtor me aktgjykim të plotfuqishëm, sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

3.13. Drejtori Ekzekutiv nuk mund të jetë:

- drejtor apo anëtar i Bordit të një OJQ-je tjetër,
- zyrtar/punonjës i institucioneve qeveritare apo
- anëtar apo pjesë e strukturave udhëheqëse të partive politike.

3.14. Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të kandidojë në zgjedhje si kandidat i ndonjë subjekti politik, vetëm pasi të tërhiqet (jep dorëheqje) nga posti i Drejtorit Ekzekutiv të organizatës. Ai/ajo nuk ka të drejtë të ri-kandidojë për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv pas dorëheqjes nga ky post për një periudhë katër vjeçare.

### **Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv**

3.15. Drejtori Ekzekutiv ka për obligim:

3.15.1. Organizimin e punës, menaxhimin e përgjithshëm të organizatës si dhe është përgjegjës për punësimin në organizatë përfshi edhe nënshkrimin e marrëveshjeve në dobi të organizatës.

3.15.2. Të emëroj dhe zgjedh zyrtarët/nëpunësit, t'i përcaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre.

3.15.3. Përfaqëson dhe mbron interesat e organizatës në takime me palë të treta.

3.15.4. Përfaqëson organizatën në prononcime në media (të shkruara apo vizuale) apo autorizon personin përkatës të Bordit të Drejtorëve apo edhe të ndonjë anëtar të organizatës.

3.15.5. Prezanton Raportin Vjetor, Financiar dhe të Punës së organizatës për aprovimin final në Kuvendin e Anëtarëve.

3.15.6. Të rrisë bazën e anëtarësisë së organizatës për përfaqësim sa më gjithëpërfshirës.





Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

### **Kompensimi financiar**

3.16. Puna e drejtorit ekzekutiv planifikohet të jetë pa kompensim financiar. Në rast të kompensimit financiar, gjegjësisht mundësive financiare buxhetore për detyra të caktuara, vendimi duhet të merret në Bordin Ekzekutiv të organizatës.

### **Përfundimi i mandatit të Drejtorit Ekzekutiv**

3.17. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv përfundon në periudhën 4 vjeçare. Mandati nuk mund të ri-vazhdohet pa ri-kandidim të sërishëm.

3.18. Nëse për çështje personale, familjare apo mjekësore Drejtori Ekzekutiv nuk mund të ushtrojë detyrën, ai mund ti delegojë detyrat e tij përkohësisht tek njëri anëtar i Bordit Ekzekutiv dhe atë në periudhë më së largu deri në 8 muaj. Në këtë rast, ky anëtar i Bordit Ekzekutiv shndërrohet në U.D. të Drejtorit Ekzekutiv. Paralelisht me këtë proces, Bordi Ekzekutiv, nëse e konsideron të nevojshme, mund të hapë thirrjen për anëtarë shtesë të Bordit për këtë periudhë të mungesës së Drejtorit Ekzekutiv.

3.19. Mandati i Drejtorit mund të përfundojë edhe nëse ai/ajo shkarkohet nga pozita. Shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv mund të kërkohet për arsyeje të:

- Shkeljes së statutit të organizatës;
- Shkeljes së Kodit etik dhe të mirësjelljes ose
- nëse Gjykata e ka dënuar për vepër penale.

3.20. Procesi i shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv mund të inicohet vetëm nëse evidentohen shkelje të përcaktuara në nenin e mësipërm dhe atë vetëm në dy raste:

- me vendim të shumicës së Bordit Ekzekutiv të organizatës; dhe
- me peticion të nënshkruar të 2/3 së anëtarësisë së Kuvendit të organizatës (pa marrë parasysh kateogrinë e anëtarëve)

3.21. Drejtori Ekzekutiv shkarkohet nga pozita nëse në takim të Kuvendit (MPV/MPJ) sigurohet shumica e votave<sup>1</sup> të anëtarëve me të drejta të plota dhe ata të asociuar.

*Aprovuar më (datë) 5 Mars 2022 në Gjakovë nga Kuvendi i Anëtarëve të GUIDEKS.*

*Përditësuar më (datë) 20 Mars 2022 në Prishtinë nga Kuvendi i Anëtarëve të GUIDEKS.*